


# Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi

Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi (KKSB), mekanizma komunalë për siguri, janë krijuar për të përmirësuar sigurinë dhe stabilitetin në bashkësi. KKSB mëtojnë që të kenë anëtarë të ndryshëm, baraspeshë gjinore, nga shtresa të ndryshme nga të gjitha bashkësitë etnike dhe fetare në komunë, të cilët kanë rol në mirëqenien afatshkurte dhe afatgjate të një bashkësie. Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Udhëzimit Administrativ nr. 03/2012 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, KKSB duhet të takohen, së paku, gjashtë herë në vit. Përveç kësaj, komunave u kërkohet që të kompensojnë financiarisht anëtarët e KKSB-ve. Deri më tani, KKSB janë themeluar në 34 komuna.


KKSB kanë një qasje gjithëpërfshirëse për të përcaktuar se çka përfshihet me sigurinë në bashkësi dhe se kush është përgjegjës për krijimin e një mjedisi të sigurt. Siguria dhe rendi në bashkësi janë përgjegjësi jo vetëm e Policisë së Kosovës, por edhe e zyrtarëve qeveritarë dhe shoqërisë civile. KKSB janë një forum i veçantë për t'i bërë bashkë këta hisedarë.

## Mandati 2018–2021


Përqindja e KKSB-ve me anëtarë grua nga komuniteti joshumicë



Komunat që respektojnë kërkesën për kompensimin e anëtarëve të KKSB-ve



## Numri i përfaqësuesve të komunitetit që nuk janë të përfaqësuar në KKSB




\* Sipas nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 të MPB dhe Udhëzimit Administrativ nr. 03/2012 të MAPL për këshillat komunalë për siguri në bashkësi, secila bashkësi që jeton në komunë duhet të ketë një përfaqësues në KKSB, pa marrë parasysh madhësinë apo ndjenjën e përkatësisë etnike të popullsisë. Kjo gjë, sidoqoftë, është e vështirë që të arrihet në praktikë për bashkësitë me popullsi shumë të vogël. Prandaj, është me rëndësi që të bëhet dallimi mes bashkësive shumë të vogla (49 pjesëtarë apo më pak) dhe bashkësive të mëdha (50 plus) kur të analizohet ajo se cilat bashkësi nuk janë të përfaqësuara në KKSB.

\* Bashkësia shqiptare e Kosovës përmendet në kontekst të atyre të cilët janë në pozitë pakice në nivel komunal.


# Puna dhe funksionimi gjatë vitit 2019

## Numri i takimeve që janë mbajtur gjatë vitit 2019


Sipas Udhëzimit Administrativ 27/2012 dhe 03/2012 duhet të mbahen gjashtë takime në vit



## Takimet e KKSBB ku u diskutuan incidentet e sigurisë, trendet e përgjithshme apo shqetësimet që prekin komunitetet joshumicë



## KKSBB që ka miratuar planin e punës bashkë me veprimtari që mëtojnë të trajtojnë shqetësimet e sigurisë dhe rendit të komuniteteve në pakicë numerike



## Takimet e KKSBB ku u diskutuan incidentet e sigurisë apo trendet e përgjithshme a shqetësimet e sigurisë të komuniteteve

